



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17 shkronja f) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 31/2008”), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.6 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 25.02.2026 miraton këtë:

### V E N D I M

#### Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Rahovec

1. Me këtë vendim **formohet** Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Rahovec, në këtë përbërje:
  - 1.1. **Lendrit Morina**, i emëruar nga Kuvendi i Komunës, anëtar - AAK;
  - 1.2. **Mirsad Shehu**, i emëruar nga Kuvendi i Komunës, anëtar - PDK;
  - 1.3. **Përparim Krasniqi**, i emëruar nga Kryetari i Komunës, anëtar;
2. Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e komisionit sipas pikës 1 të këtij vendimi janë të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 31/2008”) dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012”), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, lidhur me Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 9/2018”) dhe aktet tjera nënligjore që janë në fuqi.
3. Për punën që do ta kryej komisioni do të kompensohen nga 50€ (pesëdhjetë euro) për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë dhe pagesa bëhet nga buxheti i Komunës së Rahovecit.
4. Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.
5. Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Rahovec do të raportojë Kuvendit të Komunës së Rahovecit në bazë vjetore mbi performancën, përgjegjësitë dhe arritjen e objektivave të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Rahovec.
6. Mandati i anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve zgjatë aq sa zgjat mandati i rregullt ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Rahovec, nëse ky mandat nuk përfundon më herët.

7. Kuvendi i Komunës në Rahovec e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***NPL “Stacioni i Autobusëve” në Rahovec,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC**

**01Nr.100/26**  
**Datë:25.02.2026**

